

FTESË

Konventa Kombëtare për Integrimin Europian 2021-2023

Grupi i Punës V (Tregtia dhe Çështjet Ekonomike)

Sesioni 1, Tema: Mjedisi i biznesit në Shqipëri –përditësimi i legjislacionit shqiptar dhe harmonizimi me Acquis e BE (Kapitulli 20)

e premte, 17 qershor 2022, 09:00 – 10:30

Format Hibrid – Salla Metropol, Hotel Tirana Internacional dhe Online në Platformën Zoom

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) dhe Këshilli Kombëtar i Integritimit Europian (KKIE) në bashkëpunim me Slovak Foreign Policy Association, me mbështetjen financiare të SlovakAid ju fton në Sesionin 1 të Grupit të Punës V (Tregtia dhe Çështjet Ekonomike) “Mjedisi i biznesit në Shqipëri –përditësimi i legjislacionit shqiptar dhe harmonizimi me Acquis e BE (Kapitulli 20)” që po organizohet në kuadër të Konventës Kombëtare për Integrimin Europian 2021-2023.

Konventa fokusohet në 3 drejtime kryesore: 1) rritja e pjesëmarrjes së të gjithë segmenteve të shoqërisë shqiptare (përfshirë edhe nivelin lokal); 2) institucionalizimi i debatit publik në çështjet e BE-së bazuar në bashkëpunimin e institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile dhe ato të biznesit; dhe 3) forcimi i kapaciteteve në negociatat për integrimin në BE përmes transferimit të njohurive sllovaqe.

Në sajë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me ministrinë dhe agjencitë kyçe gjatë periudhës 2014-2021 si Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, janë krijuar disa grupe pune për të adresuar kapitujt më sfidues të negociatave të acquis së BE-së. Deri më tani janë organizuar më shumë se 40 sesione të grupeve përkatëse të punës dhe 4 aktivitete plenare, në të cilat ekspertë vendas dhe më shumë se 20 ekspertë nga Sllovakia kanë ndarë përvojën dhe ekspertizën e tyre. Këto sesione kanë mbledhur më shumë se 500 përfaqësues nga institucionet shtetërore (ministrinë, institucionet publike qendrore dhe lokale), nga sektori i shoqërisë civile, komuniteti i biznesit dhe shoqatat e punëtorëve, akademia dhe media, ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga organizma të huaj dhe organizata ndërkombëtare në Shqipëri.

Gjatë Konventës 2021–2023 po organizohen 16 sesione për katër Grupe Pune, më konkretisht: GP I – Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore (Kapitulli 23); GP II – Drejtësia, Liria, Siguria (Kapitulli 24); GP III – Bujqësia dhe Mbrojtja e Konsumatorit (Kapitulli 11, 12 dhe 28); GP V – Çështjet e Tregtisë dhe Ekonomisë (Kapitulli 1, 2, 3, 4 dhe 20).

Në kuadër të Grupit të Punës V deri më tani janë organizuar 3 sesione me tema dhe fusha që lidhen me lëvizjen e lirë të mallrave, politikat industriale dhe njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve. Për periudhën 2021-2023 janë planifikuar të organizohen katër sesione për këtë GP. **Sesioni 1** që po zhvillohet në këtë periudhë në bashkëpunim me KKIE përmban si tema kryesore mjedisin e biznesit në Shqipëri, procesin e harmonizimit të legjislacionit dhe raste praktike dhe suksesi nga Sllovakia.

Të dhënat e takimit në ZOOM janë si më poshtë:

Zoom Link:

<https://us06web.zoom.us/j/88582412349?pwd=eGREekRsRy9WcmowK0ovamxudFJjUT09>

Meeting ID: 885 8241 2349

Passcode: NCEI-AL

Ju lutemi konfirmoni pjesëmarrjen tuaj duke specifikuar nëse do e ndiqni fizikisht apo online, në: info@em-al.org.

**Gjatë aktivitetit do të ofrohet përkthim i njëkohshëm*

PROGRAMI

Konventa Kombëtare për Integrimin Europian 2021-2023

Grupi i Punës V (Tregtia dhe Çështjet Ekonomike)

Sesioni 1, Tema: Mjedisi i biznesit në Shqipëri –përditësimi i legjislacionit shqiptar dhe harmonizimi me Acquis e BE (Kapitulli 20)

e premte, 17 qershor 2022, 09:00 – 10:30

Format Hibrid – Salla Metropol, Hotel Tirana Internacional dhe Online në Platformën Zoom

08:45 – 09:00 Regjistrimi i pjesëmarrësve

09:00 – 09:05 Fjala e mirëseardhjes

Gledis Gjipali, Drejtor ekzekutiv, Lëvizja Europiane në Shqipëri

Elda Zenelaj, Drejtore e Sekretariatit Teknik, Këshilli Kombëtar i Integritimit Europian (KKIE)

09:05 – 09:15 Roli i KKIE sa i përket Kapitullit 20 – Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale

Jorida Tabaku, Kryetare e Këshillit Kombëtar i Integritimit Europian (KKIE)

09:15 – 10:00 Të bësh biznes – Politikat kryesore të BE dhe praktikat më të mira nga Sllovakia

Adriána Valášková, Këshilltare dhe Drejtore mbi Zhvillimin e Mjedisit të Biznesit pranë Ministrisë së Ekonomisë në Sllovakia

- Barrierat në Shqipëri për të bërë biznes – Informaliteti, barra administrative, falimenti etj. – praktikat më të mira nga Sllovakia – çfarë mund të mësojmë

- Politikat rajonale dhe të BE-së për sipërmarrjen dhe risitë si: dixhitalizimi, axhenda e gjelbër, ndërlidhshmëria etj.

- Roli i aktorëve të biznesit në konsultime dhe ofrimin e rekomandimeve

10:00 – 10:15 Mjedisi i biznesit në Shqipëri – sfidat që hasin operatorët e biznesit

Komente nga ekspertët shqiptarë dhe aktorët kryesorë të këtij sektori

10:15 – 10:30 Diskutim i hapur me pjesëmarrësit

10:30 Përfundime dhe mbyllja e takimit